



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:249238

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876181

KE.nr. 1544/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Demokracia”, nr. 20, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Pashko Vasa”, p.nr., me objekt kontesti kompensimi i borxhit nga baza e regresit, vlera e kontestit EUR 5,346.46, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 10.06.2024, në të cilin kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, me datë 28.06.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A., me seli në Prishtinë, dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A., me seli në Prishtinë, që në emër të regresit nga baza e sigurimit auto kasko për rastin e siguruar të datës 29.05.2017, t’ia paguaj paditësit shumën prej EUR 2,673.23, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, data 17.01.2018 e tutje, deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A., përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në shumë prej EUR 2,673.23.
- III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A., që paditësit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A., t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej EUR 172.50 (njëqind e shtatëdhjetë e dy Euro e pesëdhjetë Cent), në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### *Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:*

Paditësja Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A., 17.01.2018, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike ka paraqitur padi ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që mbi bazën e regresit paditësit t’ia paguaj shumën prej EUR 5,346.46, me kamatë ligjore prej 12%, duke filluar nga data 05.08.2017 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Ndër të tjera, paditësja në padi ka theksuar se me datë 25.08.2017, në ora 18:00, ka ndodhur aksidenti i trafikut në Veternik, Prishtinë, në mes të automjetit të siguruar kasko i markës “BMW” me targa .... dhe automjetit të markës “Opel” me targa .... i cili ka poseduar sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia me kompaninë siguroese “Sigal Uniqa Group Austria” sipas policës së sigurimit TPL 0006173356. Ndërsa, ka shtuar se i siguruari i paditëses “Stupcat Group” ka paraqitur kërkesë me datë 30.05.2017 për kompensimin e dëmit në bazë të policës së sigurimit kasko, pasi që në emër të dëmit të shkaktuar nga aksidenti ia ka paguar të siguruarit të saj shumën prej EUR 5,346.46. Në fund, ka theksuar se aksidenti ka ndodhur me fajin e të siguruarit të të paditurës dhe se pjesëmarrësit në aksidenti kanë përpiluar edhe Raportin Evropian të Aksidentit të datës 29.05.2014. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shemën prej EUR 5,346.46 në emër të regresit, me kamatë prej 12% duke filluar nga data 05.08.2017 e deri në përmbushjen definitive.

E paditura, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, përmes aktvendimit të datës 18.06.2018 është detyruar të paraqes përgjigje në padi, mirëpo që përkundër kësaj nuk ka ushtruar përgjigje me shkrim në padinë e paditëses.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin IV.EK.nr. 29/2018, të datës 11.05.2020, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që është detyruar e paditura që në emër të regresit nga baza e sigurimit auto kasko nga rasti i aksidentit i datës 25.09.2017, paditësit t’ia paguaj shumën prej EUR 4,277.17, me kamatë ligjore prej 12% duke llogaritur nga data 05.08.2017 e deri në pagesën definitive. Në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit për shumën prej EUR 1,069.30. Ndërsa, në pikën III të dispozitivit është obliguar pala

e paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej EUR 190.00 në afat prej shtatë ditësh na dita e pranimit të aktgjykimit.

Ndaj këtij aktgjykimi, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ae.nr. 119/20, të datës 08.10.2021, e ka aprovuar ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr. 29/2018, të datës 11.05.2020 e ka anuluar dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është transferuar pranë Dhomave të shkallës së parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, sipas kompetencës lëndore të kësaj gjykate.

Në rivendosje, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën përgatitore dhe atë të shqyrtimit kryesor të datës 10.06.2024, në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse.

Në seancat e mbajtura dhe fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim, përfaqësuesi i autorizuar i paditëses ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se pas administrimit të provave si ekspertizat e komunikacionit është vërtetuar përgjegjësia e të siguararit të të paditurës, ndërsa lartësia e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese nga ana e të paditurës. Me tej, ka theksuar se e paditura pa asnjë arsye e kundërshton bazën juridike të kërkesëpadisë duke kërkuar që të mos i falet besimit ekspertizave të nxjerra edhe përkundër faktit se në bazë të provave që kanë pasur në shkresa e lëndës kanë ardhur në përfundim se mund të përpilohet ekspertizë dhe se kanë konstatuar se i siguruari i të paditurës është shkaktar i aksidentit. Në fund, ka bërë edhe precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata që të njejtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A, që paditëses Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A., në emër të subrogimit t'ia paguaj shumën prej EUR 5,346.46, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë, data 17.01.2018 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Poashtu, i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore duke i specifikuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, përgjatë seancave gjyqësore si dhe në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se pala paditëse nuk ka arritur të vërtetoj bazën juridike të kërkesëpadisë, andaj e paditura nuk mund të obligohet në kompensimin e dëmit të paguar nga ana e paditësit. Tutje, ka deklaruar se edhe nga ekspertiza e përpiluar nga grupi i ekspertëve dhe sqarimet e

dhëna, është konstatuar se Raporti Evropian i Aksident është hartuar në kundërshtim me provat dhe se dëmet në automjet janë realisht të kundërta me skicën e aksidentit të pasqyruar në Raportin Evropian të Aksidentit. Në fund, ka shtuar se ky raport është në kundërshtim me dëmet materiale në automjet, andaj nuk mund të merret për bazë për të hartuar një ekspertizë dhe se nuk mund të obligohet e paditura që të kompensoj asnjë pagesë si pasoj e këtij raporti. Ndërsa, shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar

*Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar:*

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor bëri administrimin e provave si në vijim: Raportin evropian të aksidentit të datës 29.05.2017 së bashku me skicën nga vendi i ngjarjes; Kërkesën për kompensim të dëmit e datës 30.05.2017; Polisën e sigurimit kasko me nr. 36/1, e datës 03.10.2016; Urdhërpagesën për kompensimin e dëmit e datës 05.07.2017; Kërkesën për rimbursim të dëmit e datës 21.07.2017; Vendimin nr. 0667/17, të datës 06.12.2017; Foto-dokumentacionin prej 6 faqesh; Deklaratën e datës 29.05.2018; Ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti S.B., e datës 12.12.2018, si dhe; Ekspertizën e punuar nga grupi i ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, e datës 28.08.2019.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se automjeti BMW me targa ....., ka qenë i siguruar tek pala paditëse mbi bazën e sigurimit auto kasko dhe se në momentin e asindetit ka poseduar këtë lloj të sigurimit, fakt ky që vërtetohet edhe nga polisa e sigurimit auto kasko nr. 00133, e datës 03.10.2016, e lëshuar nga paditësi Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A.

Poashtu, është jokontestues fakti se automjeti i markës “Opel” me targa ....., i përfshirë në aksidentin e datës 29.05.2017, ka poseduar polisë të vlefshme të sigurimit nga autopërgjegjësia të lëshuar nga e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A.

Nga Raporti Evropian i Aksidentit nr. 1/10161284/1, i datës 29.05.2017 dhe skica nga vendi i ngjarjes e punuar nga pjesëmarrësit në aksident, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 29.05.2017 ka ndodhur asindetit i trafikut në mes të automjetit të markës BMW me targa .... i siguruar tek paditësja dhe automjetit të markës “Opel” i siguruar tek e paditura.

Nga urdhërpagesa për kompensimin dëmit e datës 05.07.2017, rezulton se paditësja i ka paguar të siguruarit të saj dëmin e shkaktuar në automjetin e tij BMW si rezultat i aksidentit rrugor të datës 29.05.2017, shumën në lartësi prej EUR 5,346.46, sipas kërkesës së këtij të fundit të datës 30.05.2017.

Nga kërkesa për kompensim e datës 21.07.2017, rezulton se paditësja ka paraqitur kërkesë pranë të paditurës për pagesën e borxhit në emër të regresit, ndërsa e paditura me vendimin e nr. 0667/17, të datës 06.11.2017 e ka refuzuar kërkesën e paditësit për kompensim të dëmit mbi bazën e TPL si rezultat i aksidentit të datës 29.05.2017.

Nga deklarata e datës 02.11.2017 e dhënë nga ngasësi i automjetit të markës “Opel” i përfshirë në aksident, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 29.05.2017 ka ndodhur aksidenti i trafikut mes të siguruarit të paditësit dhe të siguruarit të të paditurës, me c ‘rast janë shkaktuar dëme në automjetet e pjesëmarrësve në aksident.

Në ekspertizën e komunikacionit e datës 12.12.2018 e punuar nga eksperti S.B., është konstatuar se shkaktari i aksidentit të trafikut të datës 29.05.2017 ka qenë drejtuesi i automjetit të markës “Opel” e siguruar tek e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A., i cili ka qenë duke lëvizur në shiritin e djathtë të komunikacionit dhe nuk ka mbajtur distancën e sigurisë pas automjeteve para tij dhe në moment kur një automjet para tij “x” ka frenuar, ky ngasës gjithashtu ka frenuar dhe në mënyrë që të evitoj goditjen para tij ka filluar zhvendosjen në anën e djathtë duke ndërruar shirin, ku gjatë këtij manovrimi nga shiriti i djathtë në shiritin rezervë nga ana e djathtë, me pjesën anësore djathtas e ka goditur automjetin e siguruar tek e paditësi dhe në këtë rast veprimet e tij kanë qenë në kundërshtim me nenin 41,1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor. Ndërsa, sipas ekspertit drejtuesi i automjetit të markës BMW i siguruar tek paditësi “Dukagjini” Sh.A., nuk i ka dhënë kontribut aksidentit.

Nga ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve nga Instituti i Inxhinierisë Mekanike, e datës 28.08.2019, është konstatuar se deri tek aksidenti i komunikacionit ka ardhur në bazë të lëshimeve të dy pjesëmarrësve në komunikacion, pasi që drejtuesi i automjetit të markës “Opel” i siguruar tek e paditura nuk ka mbajtur distancën e duhur të sigurisë gjatë lëvizjes në rrugë dhe se ka kaluar djathtas pa u vërtetuar se me veprimin e marrë nuk i rrezikon automjetet e tjera në rrugë. Ndërsa, drejtuesi i automjetit të markës BMW për tejkalim ka shfrytëzuar shirin e paraparë për ndalje të autobusëve dhe hyrjes në qendrën tregtare “Viva Fresh Store”, si dhe ka bërë tejkalim nga ana e djathtë, veprim i ndalur në rrugët ku zhvillohet trafik në dy kahje.

Ndërsa, gjykata duke vepruar sipas sugjerimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë, në rivendosi ka ftuar grupin e ekspertëve për të dhënë sqarime lidhur me gjetjet në ekspertizën e datës 28.08.2019. Përfaqësuesi i grupit të ekspertëve, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.06.2024, ka qëndruar në tërësi pranë gjetjeve në ekspertizën e komunikacionit të punuar me datë 28.08.2019, duke shtuar se përkundër që raporti evropian i aksidentit nuk ka qenë i kompletuar në tërësi, nga deklarata e ngasësit të automjetit të tipit “Opel” të cilën e ka dhënë pranë kompanisë “Sigal” është paraqitur skica e aksidentit përmes së cilës janë nxjerrë edhe lëshimet e pjesëmarrësve në aksident, ndërsa dëmet të cilat janë prezantuar në këtë deklaratë nuk kanë të bëjnë me aksidentin dhe janë tërësisht të kundërta me fotodokumentacionin e dëmeve në automjete të prezantuara nga palët. Mirëpo, ka shtuar se kur i referohemi skicës së aksidentit të paraqitur në deklaratën e ngasës të automjetit “Opel”, dëmet në automjete përputhen.

*Baza ligjore:*

Sipas nenit 281 i Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve (tutje referuar si “LMD”) *“Kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vet ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore”.*

Ndërsa, sipas nenit 960.1 të të njëjtit ligji, është përcaktuar se *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin.”* Nisur nga kjo dispozitë, rrjedhë se me pagimin e shpërblimit nga sigurimi, siguruesi fiton të drejtën ndaj personave të tretë për të kërkuar shpërblimin e dëmit, me kusht që të vërtetohet ekzistimi i përgjegjësisë apo kontributit të personit të tretë në shkaktimin e dëmit.

Në anën tjetër, sipas nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia është përcaktuar se *“I dëmtuari ka të drejtë që kërkesën për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të autopërgjegjësive t’ia parashtrijë drejtpërdrejt siguruesit përgjegjës”,* ndërsa, sipas paragrafit 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Siguruesit mund të lidhin marrëveshje sipas të cilës kërkesa për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të autopërgjegjësive mund t’i parashtrihet dhe të trajtohet edhe nga siguruesi i drejtpërdrejtë”.*

*Vlerësimet e gjykatës:*

Bazuar në provat e administruara, deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe dispozitat ligjore të cekura si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht e bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsyet si në vijim:

Gjykata, nga provat e administruara dhe atë nga ekspertiza e grupit të ekspertëve nga Instituti i Inxhinierisë Mekanike, vërtetoi faktin se në rastin konkret deri tek aksidenti i datës 29.05.2017 ka ardhur si pasojë e lëshimeve të dy pjesëmarrësve në aksident, me c ‘rast drejtuesi i automjetit të tipit “Opel” i siguruar tek e paditura nuk e ka mbajtur distancën e duhur të sigurisë gjatë lëvizjes në rrugë dhe se ka lakuar djathtas pa u vërtetuar se me veprimin e marr nuk i rrezikon automjetet e tjera në rrugë, ndërsa drejtuesi i automjetit të tipit BMW i siguruar tek paditësja, ka shfrytëzuar për tejkalim shirin e paraparë për ndalje të autobusëve dhe ka bërë tejkalim nga ana e djathtë, veprim ky i ndaluar në rrugët ku zhvillohet trafiku në dy kahje. Të gjeturave nga kjo ekspertizë, gjykata ja fali besimin në tërësi, meqenëse e njëjta është punuar sipas standardeve profesionale dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës kontestimore.

Ndërsa sa i përket lartësisë së dëmit, përgjatë seancave të mbajtura gjyqësore mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë asnjëherë kontestuese lartësia e kërkesëpadiës, përkatësisht vlera e dëmit të shkaktuar në automjetin e markës BMW të siguruar tek paditësja sipas sigurimit auto kasko, e cila është paguar nga ana e paditëses në lartësi prej EUR 5,346.46, andaj gjykata nuk u lëshua më tepër në vërtetimin e lartësisë së dëmit material.

Nga kjo gjendja faktike e vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se përgjegjësia e pjesëmarrësve në aksidentin e datës 29.05.2017 është e barabartë për dëmet e shkaktuara në automjetin e tipit BMW të siguruar tek paditësja sipas sigurimit auto kasko, andaj në mbështetje të nenit 281 dhe 960 të LMD-së, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke detyruar të paditurën që paditësit në emër të regresit t’ia paguaj paditëses shumën prej EUR 2,673.23.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadiës së paditësit për kompensimin e dëmit përtej shumës së gjykuar si në pikën I dispozitivit të këtij aktgjykimi, meqenëse në rastin konkret, nga gjendja faktike e vërtetuar u konstatua se i siguruari i paditëses ka pasur kontribut të barabartë në shkaktimin e dëmit, andaj gjykata zbatoi institutin e ndarjes së përgjegjësisë dhe në mbështetje të nenit 192.1 të LMD-së me të cilin parashihet se *“I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose te jetë më i madh nga sa do të ishte zakonisht, ka të drejtë vetëm për kompensim përpjestimisht të*

*pakësuar*” dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar pjesën e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar në lartësi prej EUR 2,673.23.

Gjykata përgjatë vendosjes në këtë çështje kontestimore ka vlerësuar ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti S.B., mirëpo të njëjtës nuk ia fali besimin pasi që, nga kjo ekspertizë nuk ishte arritur të sqarohet plotësisht kontributi i pjesëmarrësve në aksidentin e shkaktuar dhe se e njëjta ishte në kundërshtim me provat materiale që gjenden në shkresa të lëndës, e për më tepër kontradiktore, nga fakti se eksperti ka konstatuar se mendimin e tij lidhur me rrjedhën e asinetit e mbështet në raportin e policisë edhe përkundër që në rastin konkret nuk është hartuar raport policor lidhur me aksidenti, por që pjesëmarrësit kanë hartuar Raportin Evropian të Aksidentit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës se dëmet në automjete nuk përputhen me skicën e ndërtuar në Raportin Evropian të Aksidentit nga ana e pjesëmarrësve në aksident, mirëpo gjykata gjeti se pavarësisht skicës mbi rrjedhën e pasqyruar në raportin e aksidentit, dëmet në automjete janë evidentuar në rubrikën nr. 11 të raportit të aksidentit e të cilat dëme përputhen në tërësi me provat e tjera për dëmet në automjete. Veç kësaj, dëmet në automjet përputhen edhe me skicën e pasqyruar në deklaratën e dhënë nga i siguruari i të paditurës me datë 02.11.2017.

Poashtu, gjykata vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës e cila ka theksuar se në rastin konkret për shkak të lartësisë së dëmeve nuk është dashur të hartohet raporti evropian i aksidentit pasi që i njëjti mund të përpilohet vetëm në rastet me dëme të vogla, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara pasi që me asnjë dispozitë ligjore nga Ligji Nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor (*ligj i aplikueshëm për kohën e ndodhjes së aksidentit*) dhe as nga udhëzimet mbi plotësimin e Raportit Evropian të Aksidentit nuk përcaktohet se deri në cilën lartësi të dëmit konsiderohet dëm i vogël material. Ndërsa, në aksidentit e ndodhur nuk ka pasur lëndime në njerëz apo rrethana të tjera të cilat në kuptim të nenit 211, paragrafi 3, 4 dhe 5 të Ligjit për rregullat të trafikut rrugor, do ta bënin të pavlefshëm Raportin Evropian të Aksidentit të hartuar nga pjesëmarrësit në aksident.

Në anën tjetër, gjykata pati parasysh faktin se pjesëmarrësit në aksident nuk ka bërë fotografimin e pozitës përfundimtare të automjeteve, pretendim ky i ngritur edhe nga pala e paditur, mirëpo bazuar në nenin 211, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor me të cilin parashihet *“1. Shoferët - pjesëmarrës në aksident të trafikut në të cilin është shkaktuar dëm i vogël material, janë të obliguar që menjëherë t’i largojnë mjetet nga shiriti rrugor, që ta*



*mundësojnë qarkullimin e papenguar të trafikut dhe ta plotësojnë e ta nënshkruajnë raportin evropian të aksidenteve. 2. Shoferët pjesëmarrës në aksident trafiku e plotësojnë dhe e nënshkruajnë raportin evropian të aksidenteve sipas dispozitës nga paragrafi 1 i këtij neni kur pajtohen për mënyrën se si ka ndodhur aksidenti”, nuk rezulton se pjesëmarrësit kanë pasur ndonjë obligim ligjor për realizimin e fotografive me pozitat përfundimtare të automjeteve në aksident, mirëpo ka mjaftuar që pjesëmarrësit të pajtohen me mënyrën se si ka ndodhur aksidenti dhe të nënshkruajnë Raportin Evropian të Aksidentit, me kusht që të mos ekzistojnë ndonjëra nga shkaqet e përcaktuara në paragrafët 3, 4 dhe 5 nga neni 211 i këtij ligji.*

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat e tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike kontestimore.

*Vendimi mbi kamatën ligjore:*

Vendimin mbi kamatën gjykata e mbështeti duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”,* ashtu që ka detyruar të paditurën që paditëses t’ia paguajë edhe kamatën ligjore prej 8 % në vit mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjyimit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, data 17.01.2018 e deri në pagesën definitive.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës:*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.2 të LPK-së, ashtu që shpenzimet procedurale të kërkuara nga paditësja dhe atë shpenzimet në emër të taksës për padi shumën prej EUR 60, në emër të përfaqësimit në seancën e datës 21.01.2020 nga avokati i autorizuar nw shumë prej EUR 135.00, si dhe shpenzimet në emër të shpenzimeve për marrjen e provës përmes ekspertizës së komunikacionit në shumën prej EUR 150.00, apo gjithsej shpenzimet e kërkuara nga paditësja shumën totale prej EUR 345.00, gjykata ia njohi në mënyrë proporcionale me suksesin e arritur në procedurë për 50% të përgjegjësisë së të paditurit, dhe atë gjithsej në shumën prej EUR 172.50.

Ndërsa, gjykata shpenzimet e kërkuar nga paditësja në emër të përpilimit të padisë dhe përfaqësimit në 4 seanca pranë gjykatës në shumë të përgjithshme prej EUR 644.00, nuk i njohi për faktin se padia nuk është hartuar nga ana e avokatit sikundër që paditësja, me përjashtim të seancës së datës 21.01.2020, në seancat e tjera nuk ka qenë e përfaqësuar nga avokati, dhe rrjedhimisht nuk i takojnë këto shpenzime.

Nga arsyet e cekura më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 1544/22, datë 28.06.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.